

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK



**PROGRAMI KONTRATA DHE E DREJTA KOMERCIALE
STUDIMET POSTDIPLOMIKE – MASTER**

TEMA:

Pavlefshmëria relative e punëve judike: me fokus në kontratat për bartjen e të drejtave pronësore

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Qerkin Berisha

Kandidati:

Fatos Nuli

ABSTRAKT

Me zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës është rritur edhe qarkullueshmëria secilën herë e më e madhe e sendeve në Republikën e Kosovës. Që për pasojë ka rezultuar me lidhjen e shumë kontratave si punë juridike për bartjen e të drejtave pronësore. Ndoshtë shpeshë që këto kontrata të lidhura kanë të meta të cilat mund të shkaktojnë pavlefshmërinë e tyre. Si rrjedhojë e kësaj palët duhen t'i kthejnë njëra tjetrës sendet të cilat i'a kanë marrë përmes kontratës, andaj edhe kjo dërgon në kthim mbrapa dhe ndoshta anulim të shumë kontratave të cilat po të ishin të vlefshme do t'ë ndihmonin edhe më shumë në zhvillimin ekonomik në Kosovë. Prandaj njohja e mirë e kushteve të kontratës dërgon në një siguri më të mirë juridike si dhe në një qarkullim më të shpejtë të të drejtave dhe sendeve në mes palëve kontraktuese në marrëdhënie e detyrimeve.

Shpjegimi i kushteve të cilat dërgojnë në një pavlefshmëri relative të kontratës e sidomos shpjegimi duke u bazuar në kontrata të veqanta ofron një njohuri më të thellë dhe më në detale lidhur me këtë qështje shumë të rëndësishme të marrëdhënieve juridike. Shkaqet të cilat dërgojnë në pavlefshmëri relative të një kontrate janë të cekura mirëpo përmes këtij punimi bëhet analizimi më në detale i këtyre shkaqeve duke i trajtuar ato si tema të veqanta dhe duke i spjeguar në mënyrë të ndarë nga njëra tjetra.

Natyrisht se vetëm shpjegimi teorik nganjëherë nuk është i mjaftueshëm për t'u sqaruar në përpikmëri dhe për t'u kuptuar në plotëni një temë e caktuar. Andaj është e nevojshme që të ndërlihdet edhe me pjesën praktike. Ku sidomos ndërlihdja në mes të shkaqeve që dërgojnë në pavlefshmëri relative dhe rasteve praktike në gjykatat e Republikës së Kosovës reflekton një kuptim të mjaftueshëm rreth qështjes së rrëzueshmërisë së kontratave të ndryshme.

Fjalë Kyçe: Pavlefshmëria relative e kontratave, qarkullimi i sendeve dhe të drejtave, shkaqet e rrëzueshmërisë së kontratës, rastet praktike